



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3247/ 8 prot

Datë 27.01.2026

V E N D I M
Nr. 144/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Biba X” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje” me fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Pasurisë Publike.
Adresë: Lagjja: “Gafurr Muco”, Lushnje.

Ankimues: Operatori ekonomik “Biba X” SHPK me NIPT K32618815N, me adresë: Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50 m pranë Karburant “Eurodrin”, Kavajë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.10.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje” me fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike.

II.2. Në datën 20.10.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 06.11.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë

pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “KMK” SHPK	30.746.400	lekë	skualifikuar
2- “Biba X” SHPK	31.682.160	lekë	skualifikuar
3- “Shkëlqimi” SHPK	32.350.560	lekë	kualifikuar
4- “Deha 2010” SHPK	32.617.920	lekë	kualifikuar
5- “Caushi M” SHPK	33.420.000	lekë	skualifikuar
6- “RSM Company” SHPK	36.093.600	lekë	kualifikuar
7- “Besta” SHPK	36.093.600	lekë	skualifikuar
8- “Rruga Ura Asfaltim Nr. 2 Elbasan” SHPK	36.147.072	lekë	kualifikuar
9- “Bami Holding” SHPK	36.360.960	lekë	kualifikuar
10- “Llazo” SHPK	36.360.960	lekë	skualifikuar
11- “Desaret Company” SHPK	37.189.776	lekë	skualifikuar
12- “Ndërtimi” SHPK	37.430.400	lekë	kualifikuar
13- BOE “Glavenica” SHPK & “Viscons Group” SHPK	37.430.400	lekë	kualifikuar
14- “LTE Construction” SHPK	38.232.480	lekë	kualifikuar
15- “Koloseu” SHPK & “FLED” SHPK	38.633.520	lekë	kualifikuar
16- “Kupa” SHPK	38.767.200	lekë	kualifikuar
17- “2N” SHPK	38.981.088	lekë	kualifikuar
18- “Kevin Construction” SHPK	39.997.056	lekë	skualifikuar
19- “Xhast” SHPK	41.975.520	lekë	kualifikuar
20- “Kombeas” SHPK	46.788.000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 06.11.2025 operatori ekonomik “Biba X” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

- Oferta është anomalisht e ulët.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 12.11.2025 është Publikuar Njoftim Fituesi i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 13.11.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2025/6071 dhe me nr. 3247/2025 prot, datë 13.11.2025, e operatorit ekonomik “Biba X” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje” me fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e

Pasurisë Publike. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Biba X” SHPK, me pretendimet si vijon:.

Oferta e operatorit ekonomik “Biba X” SHPK është 31,682,160 lekë pa TVSH, ndërsa oferta e operatorit ekonomik “Shkelqimi -07” SHPK i cili rezulton fitues paraprak sipas vlerësimit nga ana e Autoritetit Kontraktor Ndërrmarja e Shërbimeve Publike Lushnje, është 32,350,560 lekë pa TVSH, pra diferenca midis ketyre dy ofertave është minimale (~2.07%).

Të dyja ofertat janë shumë larg fondit limit prej 49,997,122 lekë, prandaj trajtimi i njërës si i anormalisht e ulët dhe tjetra jo është diskriminues dhe pa bazë logjike apo ligjore.

Se fundmi cenim i transparencës dhe proporcionalitetit ? Vendimi i skualifikimit nuk është i arsyetuar në mënyrë të plotë dhe nuk përmban elementet që kërkon neni 35 i ligjit për prokurimin (arsyetim faktik dhe ligjor).

Mungesa e arsytimit përbën shkelje të parimit të transparencës dhe të proporcionalitetit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e procedurës.

Per sa parashtrum dhe me lart duket haptazi e gjithë shkelja ligjore Ligjin “Per Prokurimin Publik” Ligji Nr. 162 datë 23.12.2020 Per Prokurimin Publik. Argumtojme fakte dhe prova per te cilat kemi te bejme me nje shkelje haptazi te barazis ne tendera publik, perfitimin dhe shperdorim te fondeve publike . Edhe nese autoriteti kontraktor ka vendosur te mbështetet në ndryshimet e bëra me Ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të cilat parashikojnë se në procedurat me vlerë nën kufirin e lartë monetar autoriteti mund të refuzojë ofertën që vlerësohet si anormalisht e ulët pa kërkuar më parë shpjegime, ky përjashtim nuk e përjashton detyrimin për të arsyetuar vendimin dhe për të pasur baza objektive e të verifikueshme për vlerësimin e ofertës si të tillë.

Në rastin konkret, oferta jonë prej 31,682,160 lekë pa TVSH është vetëm 2.07 % më e ulët se oferta e operatorit tjetër, ndërkohë që është rreth 36.6 % më e ulët se fondi limit prej 49,997,122 lekë pa TVSH. Këto diferenca nuk justifikojnë në asnjë mënyrë klasifikimin si “Anormalisht e ulët”, pasi janë brenda kufijve normalë të konkurrencës dhe nuk tregojnë pamundësi ekonomike apo teknike për përmbushjen e kontratës.

Për më tepër, në aktin e skualifikimit nuk është paraqitur asnjë analizë financiare apo metodologji që të vërtetojë ekzistencën e “Anormalisë”, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe në kundërshtim me nenet 3 dhe 93 të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilat kërkojnë proporcionalitet, trajtim të barabartë dhe transparencë në procesin e vlerësimit të ofertave.

Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin në konsideratë nevojën për të garantuar cilësi, vazhdimësi, aksesueshmëri, kosto, efektivitet, disponueshmëri dhe gjithëpërfshirje në shërbime, nevojat specifike të kategorive të ndryshme të përdoruesve, duke përfshirë njerëzit në nevojë dhe grupet vulnerabël, përfshirjen dhe fuqizimin e përdoruesve dhe inovacionin. Autoritetet ose entet kontraktore mund të parashikojnë që zgjedhja e ofruesit të shërbimit të bëhet mbi

bazën e ofertës që paraqet raportin më të mirë cmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3247/1 prot., datë 14.11.2025 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Biba X” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3247/2025 prot, datë 13.11.2025.

II.8. Me datë 17.11.2025 me objekt “Vendim Nr. 1448/2025, datë 14.11.2025”, dërguar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3247/2 prot datë 17.11.2025 si dhe shkresën nr. 1452 prot, datë 17.11.2025 me objekt “Dërgim dokumentacioni”, dërguar nëpërmjetë shërbimit postar protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3247/3 prot datë 19.11.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, informacion, dokumentacion si dhe aktin e trajtimit të ankesës nr. 1448/2025, datë 14.11.2025 të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës. me argumentat si më poshtë vijon:

Vendim Nr 447/2025, Data: 14/11/2025.

Personi përgjegjes i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës Nr. A/2025/6071, caktuar me Urdherin Nr. 134. prot, datë: 14/11/2025:

Objekti: Refuzim i ankesës Nr. A/2025/6071 nga operatori ekonomik “Biba X” sh.p.k për procedurën e prokurimit të hapur me objekt: “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje”, REF-63273-10-01-2025, dhe fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nente miliona e nenteqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20/10/2025, nga Autoriteti Kontraktor “Ndërmarrja e Pasurisë Publike”.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Biba X” sh.p.k me NIPT:K32618815N dhe Adrese: Tirane Lekaj Hharizaj Fshati Ktyeluzaj, Pika Inerte 50m prane Karburant “Eurodrin”.

Baza Ligjore: Nenet 112 dhe 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor “Ndërmarrja e Pasurisë Publike”, ka zhvilluar më datë 20/10/2025, ora:09.00, procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

Objekti i procedurës: “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje”,

Lloji i procedurës: Procedurë e hapur-Punë

Fondi Limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milione e nënteqind e nentëdhjetë e shtate mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH.

Në procedure kanë ofertuar 20 (njëzete) operatore ekonomikë me vlerat perkatese si meposhte:

1- "KMK" SHPK	30.746.400	lekë
2- "Biba X" SHPK	31.682.160	lekë
3- "Shkëlqimi" SHPK	32.350.560	lekë
4- "Deha 2010" SHPK	32.617.920	lekë
5- "Caushi M" SHPK	33.420.000	lekë
6- "RSM Company" SHPK	36.093.600	lekë
7- "Besta" SHPK	36.093.600	lekë
8- "Rruga Ura Asfaltim Nr. 2 Elbasan" SHPK	36.147.072	lekë
9- "Bami Holding" SHPK	36.360.960	lekë
10- "Llazo" SHPK	36.360.960	lekë
11- "Desaret Company" SHPK	37.189.776	lekë
12- "Ndërtimi" SHPK	37.430.400	lekë
13- BOE "Glavenica" SHPK & "Viscons Group" SHPK	37.430.400	lekë
14- "LTE Construction" SHPK	38.232.480	lekë
15- "Koloseu" SHPK & "FLED" SHPK	38.633.520	lekë
16- "Kupa" SHPK	38.767.200	lekë
17- "2N" SHPK	38.981.088	lekë
18- "Kevin Construction" SHPK	39.997.056	lekë
19- "Xhast" SHPK	41.975.520	lekë
20- "Kombeas" SHPK	46.788.000	lekë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, ofertuesit e mëposhtëm:

1. "LLAZO" sh.p.k, per arsye se bilancet financiare te paraqitura per vitet 2022, 2023, 2024, nuk jane të konfirmuara nga organet tatimore sic kërkohet në dokumentat e tenderit. Konkretisht, bilancet e paraqitura në SPE, kanë e vetem vule sekretarie qe verteton dorëzimin e tyre ne organet tatimore por jo konfirmimin nga ana e tyre.

Operatori ekonomik është njoftuar nëpërmjet SPE për të dhenë sqarime dhe saktësuar dokumentacionin por nuk është pergjigjur brenda afatit kohor të caktuar ne kerkesë.

2. "DESARET COMPANY sh.p.k, për arsye se nuk ploteson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik: a) "pune te ngjashme për një objekt te vetëm në një vlere jo më te vogel se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontrates qe prokurohet dhe që është realizuar gjate pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës". Punet e ngjashme nga kontrata e paraqitur nga ana e OE, nuk e plotësojne vleren prej 50% te fondit limit.

3. "KEVIN KONSTRUKSION" sh.p.k, per arsye se operatori ekonomik nuk ka pararqitur sigurimin e ofertës.

4. “Caushi M” sh.p.k, për arsye se bilanci financiar i paraqitur per vitin 2023, nuk është i konfirmuar nga organet tatimore sic kërkohet në dokumentat e tenderit. Konkretisht, bilanci i paraqitur në SPE, ka vetëm vulë sekretarie qe verteton dorëzimin ne organet tatimore por jo konfirmimin nga ana e tyre. Operatori ekonomik është njoftuar nëpërmjet SPE per të dhënë sqarime dhe saktësuar dokumentacionin por nuk është përgjigjur brenda afatit kohor të caktuar në kërkesë.

5. “BESTA” sh.p.k, për arsye se nuk plotëson kriterin 2.10 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zerave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor te percaktuar në dokumentat e tenderit”. Grafiku i punimeve i paraqitur në SPE, nuk është i detajuar dhe i ndare ne afat kohor sipas zërave të preventivit.

Pas skualifikimit te ofertuesve te lartpermendur, operatori ekonomik i renditur i pari, konkretisht OE- “K.M.K”, rezulton te jetë me vlere anomalisht të ulet (30,746,400 tridhjetë milione e shtatëqind e dyzete e gjashtë mijë e katerqind leke pa TVSH).

Oferta	20
Mesatarja e ofertave te vlefshme	36,895,680
Numri i ofertave të vlefshme	16
PR (Zm) - Zbritje te mundeshme	
PR = 85% MO	31,361,328

Bazuar në Vendimin Nr. 291,date:15/05/2024, Kreu Ii, Kufijte Monetare ne Sektorin Klasik, neni 1 dhe 2, paragrafi a dhe b, ku percaktohet se:

Kufiri i larte monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë.

2. Kufiri i ulet monetar në sektorin klasik është, si me poshte vijon:

b) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabarte ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbedhjetë milione) leke.

Rezulton se procedura me objekt: “Asaltim i rrugeve në territorin e Bashkise Lushnje”, duke patur një fond limit prej 49,997,122 (dyzete e nëntë milione e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njetete e dy) leke pa TVSH, është procedure me vlerë nën kufijte e lartë monetare.

Për këtë arsye, bazuar në Ligjin Nr.16/2024, neni 27, ku përcaktohet se: “Ne procedurat e prokurimit me vlere nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kerkuar shpjegime një oferte, e cila është konstatuar anomalisht e ulet”, oferta e operatorit ekonomik “K.M.K” shpk eshte refuzuar pa kerkuar sqarime.

Pas refuzimit të ofertës së OE “K.M.K” sh.p.k, klasifikimi ka ndryshuar.

<i>Oferta</i>	<i>20</i>
<i>Mesatarja e ofertave të vletshme</i>	<i>37,305,632</i>
<i>Numri I ofertave te vlefshme</i>	<i>15</i>
<i>PR (Zm) - Zbritje te mundshme</i>	
<i>PR = 85% MO</i>	<i>31,709,787</i>

Pas perlllogaritjeve rezulton se vlera e ofertës se OE “Biba X”, eshte anomalisht e ulet.

PR = 31,709,787 > 31,682,160 (vlera e ofertes se OE “Biba X”)

Per ketë arsye, bazuar ne Ligjin Nr. 16/2024, neni 27, ku percaktohet se: “Ne procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijte e larte monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojne pa kerkuar shpjegime nje oferte, e cila eshte konstatuar anomalisht e ulet”, oferta e operatorit ekonomik “Biba X” shpk, eshte refuzuar pa kerkuar sqarime.

Per ketë arsye,

Vendos:

1. Refuzimin e ankesës se paraqitur nga operatori ekonomik “Biba X” sh.p.k.

II.9. Me shkresen nr. 56 prot, datë 09.01.2026, me objekt “Kërkesë për përshpejtimin e marrjes së vendimit për Ankesën Nr. A/2025/6071”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3247/4 prot, datë 12.01.2025, autoriteti kontraktor kërkon përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Me shkresen nr. 787 prot, datë 20.01.2026, me objekt “Kërkesë për informacion”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3247/5 prot, datë 22.01.2026, autoriteti kontraktor kërkon përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 Për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Biba X” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Nuk ploteson kriterin 2.3.1 në lidhje me punën e ngjashme”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.3. Në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “.....**Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme**.....Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% MO$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

III.1.5. Referuar pretendimeve në ankesën e paraqitur nga ankimuesi, informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 1452 prot., datë 17.11.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3247/3 prot., datë 19.11.2025, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje” me fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, kanë ofertuar 20 (njëzet) operatorë ekonomikë nga të cilët 15 (pesëmbëdhjetë) prej tyre rezultojnë se përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi KVO-ja ka aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST. Në rastin në fjalë janë të vlefshme 15 (pesëmbëdhjetë) oferta (përfshirë këtu ofertën e shoqërisë “Biba X” SHPK, të refuzuar nga KVO-ja si ofertë anomalisht të ultë) dhe në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nga përlllogaritjet e kryera nga KPP, konstatohet, se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Biba” SHPK në vlerën prej 31.682.160 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, nuk rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është më e madhe se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme pra ofertave të 15 (pesëmbëdhjetë) ofertuesve të kualifikuar të cilët **përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme** në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Mbi bazën e këtij kualifikimi Komisioni Vlerësimit të Ofertave duhet të aplikojë formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST. Ndërkohë KVO-ja dhe KSHA-ja përlllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët për operatorin ekonomik ankimues “Biba X” SHPK nuk e ka përlllogaritur mbi mesataren e të gjithë ofertave të kualifikuara pra 15 ofertuesve të sukseshëm të cilët përmbushin kriteret kualifikuese, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë që aplikimi i ofertës anomalisht të ulët bëhet vetëm njëherë dhe vetëm mbi ofertat që **përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme**. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për rivlerësimin e ofertës ekonomik të operatorit “Biba X” SHPK pasi oferta e tij nuk është anomalisht të ulët mbështetur në përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Biba X” SHPK, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij qëndron, pasi në

këtë procedurë prokurimi, e cila referuar fondit limit të përgjithshëm të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe përcaktimeve të Kreut II “Kufijtë Monetar në Sektorin Klasik” pika 1 të VKM-së nr. 291, datë 15.05.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik” kjo procedurë prokurimi është nën kufirin e lartë monetar, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 1452, datë 19.11.2025 “Dorzim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr. 3247/3 prot, datë 19.11.2025 edhe verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), në datën 06.11.2025 janë kualifikuar ofertat e 15 (pesëmbëdhjetë) operatorëve ekonomikë, ku referuar përcaktimeve të nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta ekonomike e operatorit ekonomik ofertuesë të kualifikuar “Biba X” SHPK nuk rezulton anomalisht e ulët dhe si rrjedhim nuk është në kushtet e përcaktimeve të nenit 93 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndaj nuk mund të skualifikohet.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Biba X” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Biba X” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-63273-10-01-2025, me objekt “Asaltim i rrugëve në territorin e Bashkisë Lushnje” me fond limit: 49,997,122 (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Biba X” SHPK, dhe të rivlerësojë ofertën e këtij operatori ekonomik duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biba X” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

